



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR

KËSHILLI

VENDIM

Nr. 43 datë 30.06.2026

PËR

“MIRATIMIN E PLANIT SOCIAL VENDORTË BASHKISË GJIROKASTËR PËR PERIUDHËN 2026–2029”



Këshilli Bashkiak Gjirokastrë, në mbështetje të nenit 9, nenit 24 pika 1, nenit 54 shkronja “k” dhe nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr. 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”; Ligjit nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”; Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024–2030; si dhe pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Agjencia e Shërbimit Social dhe Shëndetësor të Bashkisë Gjirokastrë,

VENDOSI:

7. Të miratojë “Planin Social Vendor të Bashkisë Gjirokastrë për periudhën 2026–2029”, sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi.
8. Agjencia e Shërbimit Social dhe Shëndetësor, në bashkëpunim me drejtoritë dhe strukturat përgjegjëse të Bashkisë Gjirokastrë, të marrë masat e nevojshme për zbatimin e aktiviteteve dhe objektivave të përcaktuara në Planin Social Vendor.
9. Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të parashikojë fondet përkatëse në Programin Buxhetor Afatmesëm dhe në buxhetet vjetore, në përputhje me planin e veprimit dhe burimet financiare të identifikuar në dokument.
10. Strukturat përgjegjëse të Bashkisë Gjirokastrë të raportojnë periodikisht mbi ecurinë e zbatimit të Planit Social Vendor, sipas mekanizmave të monitorimit dhe vlerësimit të përcaktuara në dokument.